

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i
Gjykatës Themelore në Prizren
Prill – Qershor 2015

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur”
Nr. 4, Korrik 2015
Botues: Gjykata Themelore në Prizren
www.kgjk-ks.org

PËRMBAJTJE:

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Praktikantët e transparencës

STORIE E SUKSESIT

Dy praktikantë ndihmojnë punën e
Zyrës për Informim

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Gjykata e kënaqur me përfshirjen e ngjarjeve dhe
materialeve nga mediat lokale

INTERVISTË E SHKURTË

Ndarja e lëndëve me short e bënë punën e gjykatës
edhe më transparente (Lumni Sallauka)

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Si bëhet dorëzimi i shkresave?
A e dini se...?!

KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE NË PRIZREN



Praktikantët e transparencës

Të nderuar lexues,

Bashkëpunimi ynë me shoqërinë civile dhe Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” ka prodhuar një moment të ri në punën e Gjykatës. Të përkrahur nga praktikantë të përkushtuar, studentë të Universitetit të Prizrenit, Zyra jonë për Informim ka shtuar kapacitetet e veta njerëzore dhe operative. Në këta muajt e angazhimit të praktikantëve kemi përmbushur shumë detyra dhe kemi reliazuar një numër veprimesh në emër të rritjes së komunikimit të gjykatës me qytetarët. Jam i lumtur të konstatoj rritjen e nivelit të transparencës së gjykatës karshi qytetarëve, qëllim parësor i bashkëpunimit tonë në kuadër të iniciativës “Gjykatë e Hapur”.

Periudha tre-mujore të cilën e mbulon ky numër i buletinit tonë ka treguar për rritje të dinamikës në punët e përdtishme të gjykatës, të cilat besoj po ndikojnë edhe në konsolidimin e besimit publik ndaj Gjykatës Themelore në Prizren. Përkushtimi dhe obligimi ynë për t'i shërbyer të gjithëve pa dallim është konkretizuar edhe me prodhimin e materialeve informative në gjuhët tjera lokale të Prizrenit, përveç atyre në gjuhën shqipe. Përjecllja e rregullt dhe në mënyrë të paanshme dhe profesionale e informacionit tek publiku duke i shfrytëzuar disa kanale të komunikimit janë dëshmia më e mirë e rritjes së kapaciteteve të Zyrës për Informim Publik.

Në emër të Gjykatës Themelore në Prizren dhe në emrin tim personal, u shpreh mirënjohjet e mia më të sinqerta të gjithë bashkëpunëtorëve nga shoqëria civile, media, Universiteti dhe segmente tjera të shoqërisë për gatishmërinë e tyre që të ndihmojnë në hapjen e mëtejme të gjykatës. Vetëm me punë profesionale e të paanshme, me trajtim të barabartë të të gjithëve dhe informim të saktë e të shpejtë publik mund t'i arrijmë standardet e transparencës dhe llogaridhënies. Gjykata Themelore në Prizren është gjykatë e hapur, e cila do të vazhdojë të investojë në forcimin e standardeve profesionale dhe të transparencës.

Ymer Hoxha

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren

Dy praktikantë ndihmojnë punën e Zyrës për Informim

Me nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit në fillim të muajit prill në mes të Gjykatës Themelore në Prizren, Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe OJQ EC Ma Ndryshe, në Zyrën për Informim Publik të gjykatës filluan punën e tyre praktikantët e përzgjedhur përmes thirrjes publike dhe të vlerësuar nga një Komision Vlerësues tre palësh.

Në zbatimin e Programit të praktikantëve, gjatë këtij tre mujori praktikantët e kësaj zyre realizuan takime dhe vizita të nxënësve të shkollave fillore të qytetit dhe të studentëve të degës së Juridikut me përfaqësues të gjykatës. Vizitat u realizuan me ftesën e praktikantëve dhe kishin qëllim vazhdimin e traditës së takimeve dhe të përçojnë mesazhin për hapjen e gjykatës me qytetarë dhe grupe të tjera të interesuara.

Gjatë tre muajve të angazhimit të praktikantëve, Zyra për Informim Publik ka vazhduar me publikimin e seancave në rrjete sociale, është vazhduar me monitorimin e mediave elektronike dhe të shkruara, është punuar në përkthimin e broshurës "Si t'i qasemi gjykatës" në gjuhën turke, me qëllim që infomatat e njehta t'i shërbejnë edhe komunitetit turk. Praktikantët janë angazhuar edhe në përpilimin e këtij numri të buletinit, duke qenë gjithmonë nën mbikëqyrjen e Zyrës për Informim dhe EC Ma Ndryshe, me ç'rast janë deleguar edhe përgjegjësi të tjera brenda kërkesave të kësaj zyre.

LAJME

Studentët e Fakultetit Juridik të UPz "Ukshin Hoti" vizituan GjThPz



Praktikantët e Zyrës së Informimit të GjThPz e kanë filluar punën e tyre praktike duke organizuar grupin e parë të studentëve për të ndjekur një seancë gjyqësore dhe për të vizituar objektin e kësaj gjykate. Më 27 maj 2015, u realizua vizita e parë me rreth 15 studentë të Fakultetit Juridik nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti".

Qëllimi i vizitës ishte që studentët praktikisht të shohin ecurinë e një seance gjyqësore në mënyrë që të ju kontirbuojë në pasurimin e njohurive në fushën e tyre të studimeve. Pas përfundimit të seancës, studentët u shoqëruan nga zyrtarja për informim publik Afërdita Kicaj në hapësirat e gjykatës duke i njoftuar njëkohësisht me objektin e gjykatës dhe punën që bënë secila zyre, mjetet informuese dhe promovuese të gjykatës si dhe mundësinë që e kanë studentët për bashkëpunim me zyrën informuese. Kjo është vizita e parë me studentë në kuadër të iniciativës "Gjykatë e Hapur" dhe aktivitetet e tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen si me studentë të Juridikut gjithashtu edhe me të tjerë të interesuar, për t'u njohur me gjykatën.

Nxënësit e shkollës “Emin Duraku” njihen me punën e gjykatës



Në kuadër të iniciativës “Gjykatë e Hapur”, nxënësit e shkollës fillore “Emin Duraku” të Prizrenit, janë ftuar për vizitë në Gjykatën Themelore në Prizren. Pjesë e vizitës ishin nxënësit e klasave VI, VII dhe VIII të ShFMU “Emin Duraku” të Prizrenit të shoqëruar nga dy mësimdhënës. Vizita tematike “Njoftoju me gjykatën tënde” kishte për qëllim informimin e nxënësve rreth punës dhe shërbimeve që ofron Gjykata Themelore në Prizren dhe t’u mundësojë atyre të njihen për së afërmi me objektin e gjykatës.

Nxënësit u vendosën në njërën nga sallat e gjykimit ku u pritën nga gjykatësi Artan Sejrani nga Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni Penal dhe zyrtarja për informim publik. Z. Sejrani dhe Znj. Kicaj prezantuan punën që bënë gjykata dhe në veçanti zyret ku ata punojnë, për të vazhduar pastaj takimin me diskutim të hapur mes përfaqësuesve të gjykatës dhe nxënësve, të cilët ishin të interesuar për vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjyqtarët gjatë punës së tyre, kriteret për tu bërë një gjyqtarë, për dënimet më burgim të përjetshëm, etj. Pas diskutimeve nxënësit u shoqëruan edhe për një vizitë të shkurtë në objektin e gjykatës.

Gjykata Themelore në Prizren pret për vizitë nxënësit dhe arsimtarët e SHFMU “Mati Llogoreci”

Gjatë muajit qershor u ftuan për vizitë në Gjykatë, nxënës të klasave VI, VII dhe VIII dhe mësimdhënës të SHFMU “Mati Llogoreci” të Prizrenit. Kryetari i Gjykatës Themelore Ymer Hoxha, i priti nxënësit në zyrën e tij, ku prezantoi para nxënësve punën e gjykatës, sfidat e punës dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët. Zyrtarja për informim publik Afërdita Kicaj prezantoi punën që bënë zyra e informimit, mënyrat e komunikimit me qytetarë dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me qytetarët. Në pjesën e diskutimeve nxënësit ishin të interesuar për bashkëpunimin e gjykatës me gjykata tjera të vendit dhe rajonit, rastet e burgimeve të përjetshme dhe dënimet për të miturit.



Në pjesën e dytë të takimit, Kryetari i shoqëroj nxënësit për vizitë me objektin e gjykatës, i njoftoi me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës. Gjykata Themelore në Prizren është gjykatë e hapur, e cila përpiqet t’i përfshijë në punën e saj të gjithë qytetarët e Prizrenit. Kjo vizitë e organizuar me ftesën e iniciativës “Gjykatë e hapur” ka për qëllim të krijojë një traditë të mirë të bashkëpunimit të gjykatës edhe me shkollat e qytetit.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela më poshtë paraqet statistikën e lëndëve të Gjykatës Themelore në Prizren për gjashtë mujin e parë të vitit 2015, si ato të trashëguara në fillim të 2015, të ardhura, lëndët në proces, lëndët që janë përfunduar në këtë gjashtë muje dhe ato të mbetura në fund të gjashtëmuajt të vitit 2015. Statistikat e punës për gjashtëmuajt të parë të vitit 2015 janë dëshmia e rradhës numerike e përkushtimit maksimal të Gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore në Prizren*	Lëndët e trashëguara në fillim të 2015	Lëndët e ardhura gjatë VI-të muajt - I të 2015	Gjithsej lëndët në punë gjatë VI-të muajt - I të 2015	Lëndët e kryera gjatë VI-të muajt - I të 2015	Lëndët e mbetura në fund të VI-të muajt - I të 2015
Departamenti për Krime të Rënda	423	290	713	230	483
Departamenti i Përgjithshëm	25927	6252	32179	5948	26231
Departamenti për të mitur	241	154	395	120	275
Divizioni i Kundërvajtjes	10152	22722	32874	19315	13559
Totali	36743	29418	66161	25613	40548

*Në këto statistika nuk përfshihen degët e gjykatës në Suharekë dhe Dragash

GJYKATA NË MEDIA

Gjykata e kënaqur me përfshirjen e ngjarjeve dhe materialeve nga mediat lokale

Gjatë gjashtë muajt të parë të vitit 2015, Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar rreth 50 komunikata për media, të cilat kanë pasur për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe burgimeve, njoftimet për vizitat në gjykatë, takimet e punës dhe tryezat, konferenca për media për tremujorin e parë për statistikën e lëndëve në gjykatë. Në baza të përditshme janë dërguar edhe njoftimet për seancat gjyqësore të cilat edhe janë publikuar në rrjete sociale dhe shqiptimet e dënimeve për seancat që janë të hapura për publikun.



Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha televizionet lokale në pothuajse të gjitha rastet. Me qëllim të njoftimit të publikut për seancat gjyqësore që mbahen në gjykatë, Zyra për Informim ka vazhduar të njoftojë mediat dhe organizatat partnere në baza të përditshme me tabelën e seancave gjyqësore, të cilat kanë njoftuar rreth orës, sallës së gjyqimit, numrit të lëndës dhe gjyqtarit të lëndës. Mediat lokale kanë përfshirë dhe kanë transmetuar në mjetet e tyre të informimit në nivel shumë të kënaqshëm, ngjarjet dhe materialet e shpërndara nga Gjykata.



LUMNI SALLAUKA

Ndarja e lëndëve me short e bënë punën e gjykatës edhe më transparente

Zarfat janë të mbyllur dhe gjyqëtarët çdo fillim të mujait tërheqin zarfet, ku është e pa mundur ta dijë se çfarë lëndë ka tërhequr dhe ky veprim është jashtëzakonisht shumë pozitiv gjë që e bënë më transparente punën

e gjykatës dhe gjyqtarëve, thotë Lumni Sallauka, Gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Civil, i cili i'u përgjigj intervistës së shkurtë të këtij numri të buletinit.

1. Sa e vlerësoni të hapur gjykatën përballë publikut dhe komunikimin e gjyqtarëve me qytetarë?

Konsideroj se Gjykata Themelore në Prizren është gjykatë e hapur, e cila në vazhdimësi përpiket që t'i përfshijë në punën e saj të gjithë qytetarët e Prizrenit, për aq sa lejojnë rregullat ligjore në fuqi. E them këtë duke marrë si shembull faktin se jo çdoherë seancat gjyqësore janë të hapura për publikun, pasi që në disa çështje të caktuara për hirë të ruajtjes së privatësisë familjare, apo në lëndët ku janë të përfshirë të miturit publiku përjashtohet. Megjithatë, në funksion të kësaj tanimë është krijuar një traditë e mirë e bashkëpunimit me shumë partnerë, përfshirë këtu shkollat e qytetit, Universitetin e Prizrenit, organizatat e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare të cilat monitorojnë punën e përditshme të gjykatës.

Sa i përket komunikimit të gjyqtarëve me qytetarët, vlerësojë se ka komunikim në përputhje me rregullat ligjore, për faktin se puna e gjyqtarëve është specifike dhe këta të fundit gjithmonë duhet të respektojnë fshehtësinë e informatave që i janë besuar ose konfidencialitetin e procedurave. Gjithashtu gjyqtarët e Gjykatës tonë në vazhdimësi marrin pjesë në debate apo organizime të cilat merren me trajtimin e çështjeve që i përkasin drejtësisë, duke dhënë kontribut në informimin e qytetarëve për funksionimin dhe menaxhimin e gjykatës, kompetencën dhe procedurat që zhvillohen në gjykatë, si dhe qasjen e qytetarëve në realizimin e të drejtave të tyre përmes gjykatës.

2. Ndarja me short e lëndëve gjyqësore për secilin gjyqtar, sa po e lehtëson punën tuaj?

Fatmirësisht pas përfundimit të reformave në gjyqësor dhe riorganizimit të gjykatave që nga janari i vitit 2013, është miratuar edhe akti nënligjor përkatës me të cilën është përcaktuar edhe ndarja e lëndëve për gjykim përmes shortit. Kjo mënyrë ka ndikuar shumë në parandalimin e ndikimeve të brendshme apo të jashtme në ndarjen e lëndëve për gjykim dhe në të njëjtën kohë ja ka lehtësuar gjyqtarëve punën e tyre, pasi që këta të fundit apo palët nuk e dijnë paraprakisht se cilit gjyqtar i është ndarë cila lëndë. Bazuar në këtë praktikë pamundësohet ndikimi i ndokujt në këtë çështje, në atë mënyrë që lëndët mblidhen poshtë nga referentët dhe shënohen numrat në zarfë. Zarfat janë të mbyllur dhe gjyqëtarët çdo fillim të mujait tërheqin zarfet, ku është e pa mundur ta dijë se çfarë lëndë ka tërhequr dhe ky veprim është jashtëzakonisht shumë pozitiv gjë që e bënë më transparente punën e gjykatës dhe gjyqtarëve.

3. Sa lëndë kontestimore shqyrtoni gjatë nje muaji ju si gjyqtar ? Sipas jush cili është afati kohor më i suksesshem për përfundimin e një lënde?

Të shqyrtosh një lëndë dhe të zgjidhësh një lëndë janë çështje shumë të ndryshme. Kur flasim për shqyrtim të lëndëve, gjatë një muaji arrijë të shqyrtojë rreth 60 lëndë, mirëpo në numrin e lëndëve të shqyrtuara ndikojnë edhe shumë faktorë siç janë ndërlikueshmëria e lëndës, numri i palëve të përfshira, provat që do të shqyrtohen etj. Nga këto lëndë të shqyrtuara numri i atyre që zgjidhen përfundimisht është rreth 20-27 lëndë në muaj.

Sa i përket afatit kohor të përshtatshëm për kryerjen e lëndëve, konsideroj se kjo varet edhe nga karakteri i lëndës, kështu që për lëndë të natyrës së lehtë do të ishte e mirëseardhur që të përfundojë brenda një afati 6 mujor (varësisht nga numri i lëndëve me të cilat është i ngarkuar gjyqtari), ndërsa lëndët më të ndërlikuara do të duhej të zgjidhen brenda një afati prej një (1) viti. Përfundimi i një çështje civile nënkupton edhe përfundimin e kësaj lënde në procedurën përmbartimore. Mendim pothuajse të njëjtë për këtë çështje ka edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilin e ka shprehur përmes vendimeve të saj, në rastet kur ka konstatuar se ka pasur shkelje nga shtetet të nenit 6 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

4. Gjatë punës suaj të përditshme, cilat lëndë gjyqësore mund të quhen më problematike dhe si i tejkaloni vështirësitë në zgjidhjen e tyre?

Meqenëse unë si gjyqtar gjykoj lëndët civile në procedurën kontestimore, konsideroj se jo të gjitha lëndët janë të peshës dhe karakterit të njëjtë. Në këtë drejtim rol të rëndësishëm luan lloji i kontestit, numri i palëve ndërgjyqëse, raportet në mes tyre, numri i provave materiale që do administrohen, zbrastësirat ligjore, pjesëmarrja e fëmijëve në këto konteste etj. Mund të jenë disa kriteret të cilat një lëndë e bëjnë problematike dhe të vështirë për tu zgjidhur. Në këtë grup hyjnë lëndët të cilat objekt të padisë kanë kryesisht vërtetimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë, kontestet martesore në të cilat janë të përfshirë fëmijët e mitur (besimi i fëmijës, alimentacioni, kontaktet personale, vërtetimi i atësisë dhe amësisë), dhuna në familje etj. Zgjidhja e këtyre lëndëve sigurisht që kërkon përgaditje paraprake të lëndës, përkushtim, profesionalizëm, trajtim të barabartë të palëve dhe vendosje brenda një afati të arsyeshëm kohor.

5. Qytetarët janë të shqetësuar për vonesat në shqyrtimin e lëndëve, si po e menaxhoni këtë situatë?

Konsideroj se në tre vitet e fundit ka një përmirësim të dukshëm në rritjen e efikasitetit dhe performancës së gjykatës tonë në shqyrtimin e lëndëve brenda një kohe të arsyeshme dhe në përputhje me nenin 6 të Kartës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Këtë e dëshmon fakti se nëse një gjyqtar civilist në vitin 2010 ka qenë i ngarkuar me rreth 1500 lëndë të natyrave të ndryshme, atëherë në vitin 2015, të njëjtit kanë në punë rreth 150-200 lëndë. Kjo shifër na jep të kuptojmë se në gjykatën tonë është punuar shumë dhe vazhdon të punohet, në mënyrë që qytetarëve tanë ti mundësohet që të drejtat e tyre ligjore dhe kushtetuese ti realizojnë në afat optimal. Nga kjo rezulton se tani ka rënë në masë të madhe numri i ankesave të parashtruara nga qytetarët me arsyen e mos kryerjes së lëndëve, ndërsa këtë e vërteton edhe fakti se kryetari i gjykatës apo ne si gjyqtar pranojmë një numër fare të vogël të këtyre ankesave. Andaj, mund të vijmë në përfundim se edhe përceptimi i publikut në këtë rast ka ndryshuar për të mirë dhe në të njëjtën kohë është rritur në masë të madhe besimi i publikut në punën e gjykatës tonë.

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Si bëhet dorëzimi i shkresave ?

Qytetarët kanë në dispozicion disa mundësi që t'i dorëzojnë gjykatës shkresat e tyre. Shkresat mund ti dorëzohen gjykatës:

- Personalisht;
- Përmes shërbimit postar;
- Çfarëdo mjeti tjetër të dorëzimit të shkresave.

Të gjitha shkresat e dërguara gjykatës përmes postës apo personalisht i dorëzohen referentit të pranimit. Shkresat e pranuar vulosen nga referenti i pranimit, pa i hapur ato. Për të gjitha parashtrësit gjyqësore për të cilat kërkohet pagesa e taksës gjyqësore, zbatohet udhëzimi administrativ mbi unifikimin e taksave gjyqësore.

A e dini se...?!

1. Caktimi i lëndëve tek gjyqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranuar brenda muajit kalendarik nga personeli i administratës së gjykatës, ndahen në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti, qoftë gjyqtari në pozitë të kryetarit të trupit gjykues në gjykatë të shkallës së parë, qoftë kryetar i kolegjit gjyqësor në gjykatë të shkallës së dytë apo të tretë. (Rregullore mbi organizimin e brendshëm të Gjykatave, Neni 24, Caktimi i lëndëve, paragrafi 1)

2. Tërheqja e shortit bëhet nga gjyqtari respektivisht i autorizuari i gjyqtarit. Dita e shortit do të jetë të hënën e dytë të muajit. Kur e hëna është ditë pushimi (feste), shorti tërhiqet në ditën pasuese të punës. (Si më lart, paragrafi 2)



KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE NË PRIZREN

ZYRA E ADMINISTRATËS:

Tel: +381 (0) 29 / 244 122

ADRESA:

Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë

VIZITO:

www.kgjk-ks.org



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

OSNOVNI SUD U PRIZRENU –PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

Ky dokument është rezultat i bashkëpunimit mes Gjykatës Themelore në Prizren dhe EC Ma Ndryshe, në kuadër të iniciativës "Gjykatë e Hapur".